

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11)), sidhe n; bazë të nenit 50 alinea 6 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së veriore “ nr.161/2019)Ministri për arsim dhe shkencë e solli programin e shkurtuar nga lënda **Gjuhë angleze** e klasës së I të arsimit fillor nëntëvjeçarë të vitit shkollor 2020/21.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



PROGRAMI I SHKUARUAR MËSIMOR

GJUHË ANGLEZE

Për klasën e I

Të arsimit fillor nëntëvjeçar

SHKUP, 2020

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **Gjuhë angleze** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura, të parashikuara me programin e rregullt mësimor për këtë lëndë.

Në programin e shkurtuar janë të përcaktuara tema dhe njësi mësimore të cilat duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, duke pasur kujdes fondin e orëve javore të paraparë në programin e rregullt mësimor, 2 orë në javë gjegjësisht 64 orë gjithsej.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet, metodat e aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda Gjuhë angleze për klasën e I realizohet në vitin shkollor 2020/21

2. Pasqyra e temave¹

TEMA 1 . UNË DHE TË TJERËT NË SHITËPI (16 ORË)

TEMA 2. UNË DHE TË TJERËT NË MJEDISIN SHKOLLOR (16 ORË)

TEMA 3. UNË DHE TË TJERËT NË MJEDISIN E DREJTËPËRDREJTË (16 ORË)

TEMA 4. UNË DHE TË TJERËT NË KOHË TË LIRË (16 ORË)

Duke pasur parasysh fondin e orëve të paraparë në programin e shkurtuar, rekomandohet qasja holistike gjatë të të mësuarit të gjuhës angleze gjatë shtjellimit të temave që relizohen me tipe të ndryshme orësh të cilat përfshijnë jo vetëm përvetësimin e njësive leksikore por edhe strukturave gramatikore si dhe funksionet gjuhësore të parashikuara që ndërsjellin përvetësimin më efikas të gjuhës,(dëgjim,lexim me kuptim, të flasë mirë dhe të shkruaj drejtë gjuhën angleze.

Më pastaj, rekomandohet prezentimi cilësor i përmbajtjeve të reja, zbatimi i aktiviteteve të parapara, si dhe ushtrimi i tyre.

¹ Во однос на дадените теми и понудениот број на часови за истите, наставникот/наставничката прави проценка за начинот и обемот при обработката на секоја тема поединечно, притоа земајќи го предвид интегрираниот и избалансираниот пристап при изучување на сите јазични елементи, согласно можности на учениците и нивните потреби.

Multikulturalizmi, përmbajtjet interkulturele dhe lexim- shkrimi mediatik janë pjesë përbërëse e mësimin të gjuhës angleze si gjuhë e huaj.

3. Rekomandimet didaktike

Pikënisja e realizimit të programit të shkurtuar nga lënda e Gjuhë angleze është programi i rregullt mësimor i kësaj lënde (rezultat e e pritura, përmbajtjet dhe nocionet, metodat dhe standardet për vlerësim).

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar mësimor të lëndës Gjuhë angleze si gjuhë e huaj, nisemi nga qasja e integruar pa bërë ndarjen e komponenteve dhe shkathtësive të përcaktuara gjuhësore (së bashku gramatika fonetika) në krahasim me numrin e orëve të planifikuara. Sidomos, gramatika nuk duhet përvetësohet me memorim të rregullave dhe definicioneve, por përmes kontesteve me shembuj, që të kuptohet domethënia dhe e zbatimi autentik i gjuhës.

Tek orët e mësimore të Gjuhës angleze të klasës së parë rëndësi ka të shprehurit me gojë në situata të caktuara në klasë, përmes lojërave të ndryshme, dramatizimeve, këngëve ose lëvizjeve duke nxitur imagjinatën dhe kreativitetin e nxënësve.

Marrë në përgjithësi nxënësit e kësaj moshe i përvetësojnë përmbajtjet në mënyrë mekanike me riprodhim), por me rëndësi është që ata të shqiptojnë drejtë dhe të kuptojnë domethënjen e porosisë. Fokusi i arsimtarit duhet të jetë që të fus nxënësit në përvetësimin e gjuhës përmes shkathtësisë së të dëgjuarit, të të folurit me të të kuptuar. Duhet tu jipet kohë e mjaftueshme që secili nxënës të lirohet dhe fillojë të flas edhe nëse shqipton gabim ndonjë fjalë..

Mësimi i gjuhës angleze të nxënësit e kësaj moshe bëhet me mësim multisenzorë (vizuele, auditive, taktile dhe të tjera) dhe mësim holistik që i përfshin aspektet kognitive, afektive dhe motorike, gjegjësisht arsimtari i integron komponentet e ndryshme që gjuha të mësohet në mënyrë funksionale

Gjatë zgjedhjes së aktiviteteve duhet të kihet kujdes për diferencim dhe të zgjidhen aktivitete të përshtatshme që të mahet vëmendja e përqendruar e fëmijëve.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programi i shkurtuar mësimor e realizon arsimtari sipas normativit për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar nga lënda Shkencat natyrore të klasës së parë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi

MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Mila Carovska